




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: **11.08.2021**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. 11.08.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik GLOBI-M.I. SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Rregullimi i hapësirave publike - shesheve** ” me **nr të prokurimit 651-21-3664-2-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 21 040 221** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Operatori Ekonomik GLOBI-M.I. SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Rregullimi i hapësirave publike - shesheve** ”, **me nr të prokurimit 651-21-3664-2-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 21 040 221** e dt. 11.08.2021 kundër Njoftimit të Autoritetit Kontraktues si dhe Letrave Standarde të datës **06.08.2021** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas** Njoftimit të Autoritetit Kontraktues si dhe Letrave Standarde të datës **06.08.2021**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik GLOBI-M.I. SH.P.K. me datë 11.08.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Rregullimi i hapësirave publike - shesheve**”, **me nr të prokurimit 651-21-3664-2-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 21 040 221**. Autoriteti Kontraktues me datë 11.08.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket Pretendimeve Ankimore, AK – Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit konstaton se : Duke u bazuar në Kërkesën tuaj për qasje në dokumente, AK- Autoriteti Kontraktues në bazë të RROUP më saktësisht Pika 7, ku potencohet 7.1 , 7.3, 7.5, 7.6, 7.7 :

7.1 Tenderët në process të tenderitmit zakonisht dorëzohen në baza konfidenciale. Në mënyrë që të ruhet integriteti I procesit dhe të respektohet pozita konfidenciale dhe konkurruese e tenderuesve, detajet e tenderëve, përveç informative të cilat komunikohen gjatë seancës publike të hapjes, duhet të mbesin secrete, deri në përfundim të aktivitetit të prokurimit.

7.3 Pas përfundimit të aktivitetit të prokurimit vetëm informatat e klasifikuara, nga OE dhe të pranuar nga AK, si secrete të biznesit do të mbesin secrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.

7.5 Informacionetë cilat mund të klasifikohen si informacione secrete të biznesit janë :
a. Informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 I LPP-së; dhe
b. Informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 I LPP-së.

7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse :
a. Një kërkesë me shkrim dorëzohet nga tenderuesi potenciale duke përdorur formularin standard “ Kërkesë për Konfidencialitet “ që është një Aneks në Dosjen e Tenderit.

7.7 Sistemi I Prokurimit elektronik iu mundëson OE që të deklarojnë dokumentet si konfidenciale në harmoni me nenin 68 dhe 69 të LPP-së. Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si konfidenciale nuk janë vënë në dispozicion operatorëve të tjerë ekonomik.


Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Izet Kurteshi



Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.